



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI KOMBËTAR I KONTABILITETIT**

---

**Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit**

**Lënda: Raport i stafit të KKK mbi punën e bërë gjatë vitit 2016**

Ky vit në pjesën më të madhe ka mbuluar përgatitjen e një materiali të rëndësishëm në zbatim të SKK-ve të përmirësuara, rishikimin e SKK 15, bashkëpunimin me konsulentin e huaj për disa rregullime ligjore lidhur me klasifikimin e njësive ekonomike dhe punë të detajuar për amendimet ligjore nisur nga tabela e përputhshmërisë me Direktivën 34/2013.

Kjo periudhë ka mbuluar edhe organizimin e disa aktiviteteve ku më i rëndësishmi është organizimi i Konferencës.

Gjithashtu, linearisht është punuar për të përmbushur të gjitha detyrat administrative të stafit, përfshirë hartimin, realizimin dhe raportimin e shpenzimeve buxhetore.

**Detyrat e mbuluara në 6-mujorin e parë...**

**I. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit**

*a- Komentari për plotësimin e pasqyrave financiare sipas SKK 2 të përmirësuar*

Gjatë muajit janar dhe shkurt u punua për hartimin e tekstit “Komentari për plotësimin e pasqyrave financiare”. Përgatitja e komentarit kaloi në dy faza: së pari u konceptua si një material i plotë nga stafi dhe më pas u organizuan tryeza të rumbullakëta me palë interesi për të mbledhur komentet dhe sugjerimet e tyre për shtesa dhe pakësime në tekst.

Komentari u ndërtua në tre pjesë:

- pjesa e parë, mënyra e plotësimit të pasqyrave ku jepet lidhja mes llogarive dhe pozicionit përkatës të tyre në pasqyrat e pozicionit apo performancës financiare
- pjesa e dytë, pasqyrat financiare sipas SKK 2 të përmirësuar
- pjesa e tretë, lista e përmirësuar e llogarive

Varianti final më pas kaloi në mbledhjet e Bordit për miratim. Komentari u publikua në 500 kopje, për vlerën 66.000 lekë. Shitja filloi në gjysmën e dytë të muajit mars dhe gjithsej u shitën 250 copë, çmimi 400 lek/copa.

#### *b- Rishikimi i SKK 15*

Që në vitin 2015 ishte parashtruar në planet e KKK-së rishikimi i SKK 15, si logjikë e rishikimit të plotë të paketës së standardeve kombëtare. Për rishikimin e SKK 15 puna filloi me rishikim e tekstit me synimin:

- Përditësimin e terminologjisë
- Thjeshtimin e kërkesave të standardit
- Riparaqitjen e pasqyrave financiare sipas modelit të SKK2 por shumë më të thjeshtuar

Materiali i konceptuar nga stafi kaloi në bord për diskutime dhe pas tre mbledhjeve të njëpasnjëshme u miratua. Më pas iu dërgua për shpallje ministrit të financave.

Përmirësimet përmbliidhen si më poshtë:

#### *1. Terminologjia*

- Zëvendësohet termi “pasiv” me termin “detyrim”
- Zëvendësohet termi “bilanc” me termin “pasqyra e pozicionit financiar”
- Rishikohen të tjerë terma dhe fjalë të vjetëruara

#### *2. Disa ndryshime të kërkesave të standardit 15*

- Rindërtohet struktura e standardit sipas parimit:
  - Objekti, objektivi, përkufizimet...
  - Njohja, matja dhe paraqitja
  - Shënimet shpjeguese
- Hiqet kërkesa për zhvlerësimin e AAM dhe AAJM (ish pg 16)
- Riformulohet paragrafi (ish pg 47 – tani pg 52) për vlerësimin në fund të inventarëve të cilët do të paraqiten vetëm me kosto
- Hiqen kërkesat për njohjen e aktiveve dhe detyrimeve të kushtëzuara (ish pg 20, 21)
- Hiqet kërkesa për provizionimin e kërkesave për arkëtim (ish pg 53)
- Shtohet pg 14, përkufizimi i vlerës së rikuperueshme
- Shtohen dy paragrafë, 40 dhe 41, të marrë nga SKK 1 lidhur me momentin e njohjes së elementeve të pasqyrave financiare
- Shtohet paragrafi 54 për përkthimin e zërave monetarë dhe jo monetarë në pasqyrat financiare

#### *3. Riparaqitja e pasqyrave*

Për rishikimin e pasqyrave u mor si model formati i SKK 2 duke e thjeshtuar sipas kërkesave të SKK 15.

## II. Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 stafi ka përkthyer dhe rishikuar, duke përdorur programin Trados, standardin ndërkombëtar të raportimit financiar për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (SNRF për NVM), version i vitit 2015. Versioni më i fundit i përkthyer nga përkthyesit e komitetit të rishikimit, jo me anë të Trados, ishte ai i vitit 2009. Ky material është rishikuar fjalë për fjalë duke bërë edhe përkthimet e nevojshme për materialet shtesë. Më pas materiali i ri është dërguar pranë IASB ku është miratuar si version i fundit dhe nga IASB me anë të kontratës përkatëse këtë version, në gjuhën shqipe ia ka dërguar Bordit Kososvar për Raportimin Financiar, pasi në Kosovë ky standard është i detyrueshëm për zbatim.

Gjatë kohës kur stafi po përgatitej për konsolidimin e versionit të vitit 2016 për SNRF, nga IASB vjen SNRF 16 *Qiratë financiare* si një material i cili edhe pse ka ardhur në vitin 2016 duhet të jetë pjesë e konsolidimit version i vitit 2016. Materiali iu kalua për përkthim dhe rishikim komitetit të rishikimit.

Azhornimet e mbërritura në 6-mujorin e parë janë si në vijim:

<i>Titulli</i>	<i>datë efektive</i>
Ndryshime të SNK 12	1 janar 2017
Ndryshime të SNK 7	1 janar 2017
Ndryshime të SNRF 15	1 janar 2018
Ndryshime të SNRF 2	1 janar 2018

## DETYRA TË TJERA

### a) Pyetësi për vetvlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2015

Nga ana e stafit të KKK plotësohet çdo vit pyetësi i vetvlerësimit i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin paraardhës. Ky pyetësor dërgohet çdo vit nga Ministria e Financës (është i disponueshëm dhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financës) dhe është i detyrueshëm për t'u dorëzuar më datë 1 Mars.

Ky dokument tregon përgjegjësitë kryesore të Nëpunësit Autorizues në kuadrin e implementimit të konceptit të përgjithshëm menaxherial. Me anë të tij bëhet vetvlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm brenda institucionit.

Ky pyetësor ka pesë komponentë:

- 1.Mjedisi i kontrollit
- 2.Menaxhimi i riskut
- 3.Aktivitetet e kontrollit
- 4.Informimi dhe komunikimi
- 5.Monitorimi

**b) Deklarata dhe raporti mbi cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2015**

Pas plotësimit të pyetësorit të mësipërm Nëpunësi autorizues hartoi dhe deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm për institucionin.

Nëpunësi autorizues deklaroi përgjegjësinë për menaxhimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të burimeve financiare dhe jofinanciare të njësisë, monitorimin që i ka bërë sistemit të kontrollit të brendshëm të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit gjatë vitit raportues 2015 duke krijuar një mjedis kontrolli, menaxhimi të riskut, veprimtarisë së kontrollit, nëpërmjet marrjes së informacioneve dhe komunikimeve të vazhdueshme me vartësit, nëpërmjet vlerësimeve dhe analizave në vazhdimësi, nëpërmjet vendosjes së një sistemi rregullash dhe procedurash të brendshme të njësisë.

**c) Progres raporti – mbledhja në Tiranë**

Në takimin e nënkomitetit të tregun e lirë dhe konkurrencën, që u mbajt në Tiranë në muajin maj 2016, KKK e përfaqësuar nga një anëtar i stafit, paraqiti përpara delegacionit të KE një material përmbledhës të detyrave të realizuara gjatë vitit 2015. Si misionet kryera me sukses u paraqitën miratimi dhe publikimi i tekstit të SKK të përmirësuar, dhe tjetri, hartimi i SKK për OJF-të. Ndërsa lidhur me rekomandimin tashmë të përvitshëm të komisioni për rritjen e kapacitetit inspektues të KKK, përgjigja ishte e njëjtë. Kapacitete inspektuese të KKK nuk kanë asnjë mundësi të rriten por vazhdon kqyrja e seteve të herëpashershme të pasqyrave pranë QKR-së.

**d) Vëzhgime të pasqyrave të siguruara nga KKK**

Gjatë 6-mujorit të parë janë kontrolluar rreth 200 njësi ekonomike, pasqyrat e tyre financiare. Edhe pse standardet kombëtare apo ndërkombëtare janë në fuqi prej vitit 2008, sërish ka gjetje që tregojnë për mangësi në zbatimin e këtyre standardeve. Për gjetjet i është dërguar shkresë BMP. Problematikat e hasura i janë bërë të ditura Bordit të KKK nëpërmjet mbledhje rast pas rasti por më poshtë listohen të përmbledhura:

**1. Shoqëria “TRAJTIMI I STUDENTËVE VLORË” sh.a (K 56703241 T)**

Në raportin e auditimit (EKR - Luan Muça dhe Niko Mijo) të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2014, thuhet shprehimisht se drejtimi është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve ndërsa në opinionin e tyre shprehen “...në përputhje me Standardet Kombëtare të Raportimit Financiar”.

**2. Shoqëria “UJËSJELLËSI SELENICË” sh.a (K 47127201 C)**

Në raportin e auditimit (EKR – Kastriot Haxhaj dhe Ramazan Ademi) të pasqyrave financiare të mbyllura më 31 dhjetor 2014, thuhet shprehimisht se drejtimi është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare sipas SNRF-ve ndërsa në opinionin e tyre shprehen “...në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit”.

### **3. Shoqëria “ZICO” sh.a (K 61812006 M)**

Problemi i vërejtur ka të bëjë me faqen e parë të pasqyrave financiare, ku informacioni i paraqitur tregon se pasqyrat janë ndërtuar mbështetur në SKK 15. Kjo njësi ekonomike plotëson kushtet për zbatimin e SKK-ve (1 – 14). Në raportin e auditit (EKR Ylvi Hana dhe Bujar Rami) nuk ka asnjë konstatim lidhur me këtë parregullsi.

### **4. Shoqëria “ASTRA ALBANIA” sh.a (J 62325008 K)**

Kjo njësi ekonomike plotëson kushtet për zbatimin e detyrueshëm të SNK / SNRF-ve në hartimin e pasqyrave financiare pasi tejkalon për dy vite rradhazi shifrën e afarizmit (mbi 1.250 milion) dhe të punësuar (mbi 100 persona). Pasqyrat financiare 2014 janë ndërtuar mbështetur në standardet kombëtare të kontabilitetit ndërsa në raportin e auditit (Deloitte Audit Albania, Elvis Ziu – Partner) nuk është konstatuar kjo parregullsi. Opinioni i dhënë gjen se pasqyrat paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale rezultatin financiar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

### **5. Shoqëria “OPTIMUM MEDIA” sh.a (K 81504069 I)**

Njësia ekonomike i ka hartuar pasqyrat sipas SKK 2, sepse nuk plotëson kriteret për SNRF por audituesi Baker Tilly në opinion e vet shprehet se i gjen pasqyrat korrekt sipas SNRF-ve.

### **6. Shoqëria “ELKA” sh.a (K 03124608 J)**

Njësia ekonomike i ka hartuar pasqyrat sipas SKK 2, sepse nuk plotëson kriteret për SNRF por audituesi Leze Abazi në opinion e vet shprehet se i gjen pasqyrat korrekt sipas SNRF-ve. Nga komunikimi me audituesin njihemi me faktin se njësia prej vitit 2008 zbaton në mënyrë të vullnetshme SNRF-të edhe pse nuk i plotëson kriteret për zbatimin e detyrueshëm dhe informacioni financiar i paraqitur është njohur matur dhe vlerësuar sipas SNRF por paraqitur sipas SKK 2, sipas presionit të tatimorëve dhe administratorit!!!

#### **e) Faqja e internetit – programi i transparencës**

Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, stafi përditëson programin e transparencës me frekuenca tre mujore. Publikohen në faqen e internetit regjistri i prokurimeve (parashikimi dhe fakti) si dhe shpenzimet buxhetore. Në linkun e posaçëm publikohen edhe vendimet e rëndësishme të Bordit. Për gjashtëmujorin e parë gjithçka është publikuar sipas kërkesave të ligjit të sipërcituar.

## **f) Kthim përgjigje subjekteve**

Tashmë është një rutinë normale pune që subjekte të ndryshme i drejtohen me shkresë ose me email stafit të KKK për interpretime apo sqarime lidhur me standardet apo udhëzuesin në zbatim të tyre. Përgjigjet, shkresore apo përmes emailit publikohen më pas në faqen zyrtare me qëllim që t'u shërbejnë dhe njësitë të tjera që mund të hasin të njëjtat paqartësi në punën e tyre. Problemi që ka shqetësuar një nga kompanitë e mëdha në Shqipëri, kompaninë ASHTA është problemi i koncesioneve. Bordi pas diskutimeve në mbledhjet e rradhës mbajti një qëndrim përfundimtar që të gjitha njësitë ekonomike subjekte të marrëveshjeve koncesionare do të zbatojnë korrektësisht SKK 13 duke bërë ndërhyrjet e duhura në rastin e zbatimit jokorrekt të IFRIC 12, përpara datës së hyrjes në fuqi të SKK 13.

## **g) Tryezat e rrumbullakëta**

Gjatë gjashtëmuorit janë organizuar katër tryeza të rrumbullakëta përkatësisht:

- Tiranë 18.02.2016– “Për plotësimin e pasqyrave financiare sipas SKK 2 të përmirësuar”
- Tiranë 12.04.2016– “Problematikat në zbatimin për herë të parë të SKK-ve të përmirësuara”
- Elbasan 27.04.2016– “Problematikat në zbatimin për herë të parë të SKK-ve të përmirësuara”
- Durrës 29.04.2016– “Problematikat në zbatimin për herë të parë të SKK-ve të përmirësuara”

Tryezat kanë patur një pjesëmarrje shumë të kënaqshme, mbi 30 pjesëmarrës, më shumë pjesëmarrës se planifikimet tona për sallat. Diskutimet rreth tematikës së tryezës kanë qenë shumë të vlefshme për të mbledhur më pas materialin e nevojshëm për organizimin edhe të konferencës.

## **h) Konferenca Kombëtare**

Konferenca Kombëtare me temë "Risitë dhe problematikat në zbatimin për herë të parë të SKK-ve të përmirësuara" u zhvillua më atë 07.06.2016. Pjesëmarrja ishte një nga sukseset e kësaj konference. Përballimi i shpenzimeve të saj me financime jashtë buxhetit të KKK-së ishte një tjetër fakt për t'u vlerësuar. Pasqyrimi i zhvillimeve të Konferencës edhe në materialet e publikuara të Bankës Botërore flet për seriozitetin dhe rolin e KKK-së në fushën e raportimit financiar. Përsa i përket diskutimeve dhe problematikave të ngritura, Bordi është vënë në dijeni në mbledhjen e qershorit.

### ***Përmbledhje e problematikave të dala nga Konferenca Qershor 2016***

1. Rishikimi i ligjit të kontabilitetit dhe i pasqyrave financiare, për harmonizëm të mëtejshëm me direktivën, si dhe për të reflektuar problematikat e dala nga zbatimi në praktikë deri tani.

2. Fuqizimi i kapaciteteve të universiteteve dhe institucioneve profesionale.
3. Rritje e kapacitetit të autoritetit tatimor për t'i kuptuar më mirë standardet e raportimit financiar dhe për të pajtuar dallimet mes raportimit për qëllime fiskale dhe raportimit për qëllime të përgjithshme.
4. Përmirësimi i kapacitetit të BMP-së dhe enteve rregullatore financiare për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të raportimit financiar.
5. Fuqizimi i kapacitetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
6. Përditësimi i tabelës së përputhshmërisë së ligjit të kontabilitetit (përfshirë dhe amendimet e reja të propozuara) me direktivën e re të kontabilitetit të BE.
7. Mbështetje në rishikimin e klasifikimit të njësive ekonomike për arsye të përdorimit të pasqyrave financiare.
8. Rritja e ndërgjegjësimit të inspektorëve tatimorë për një njohje sa më të mirë të SKK-ve , si ndihmesë në punën e tyre.
9. Duhet më shumë kohë dhe punë që impakti i ndryshimeve /përmirësimeve të SKK-ve të jetë i dukshëm dhe eficient.
10. Bankat të përgatisin një program gjithpërfshirës trajnimi për punonjësit që janë pjesë e procesit të kreditimit, ku vend të rëndësishëm zë analiza financiare. Duke u konsultuar me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit të përfshihen në këtë program trajnimi edhe ndryshimet e SKK-ve.
11. Të mos preken kufijtë e auditimit sepse çënohet cilësia. KKK nuk mund dhe e ka si tagër këtë opsion.
12. KKK në bashkëpunim me organizmat profesionale, por edhe me konsulentë të pavarur siç mund të jenë konsulentët e projektit të Bankes Botërore, përveç manualit të zbatimit të SKK-ve, të hartojë një dokument më të përmbledhur në formën e një checkliste për zbatimin e SKK-ve të përmirësuara, me anën e të cilit të referohet për çdo zë në pasqyrat financiare, numri i standardit dhe paragrafi që zbatohet. Kjo punë do të ndihmojë jo vetëm për aspektet e njohjes, matjes dhe paraqitjes, por edhe për të bërë një vlerësim të përgjithshëm të paraqitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme.
13. Pasqyrat financiare të jenë sa të thjeshta aq edhe të qarta.
14. Duhet më shumë detaje dhe udhëzime për SKK 13.
15. Standardi 13 (në lidhje me aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare) duhet të sqarojë statusin kontabël të aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, të sqarojë dhe shpjegojë qënien të amortizueshme apo jo të amortizueshme, të saktësojë periudhën dhe trajtimin kontabël të derisotëm dhe trajtimin kontabël nga sot e tutje.
16. Çdo njësi ekonomike të përgatisë vetëm një paketë të plotë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare dhe SKK. Kjo paketë të furnizojë me informacion edhe Bankat edhe INSTAT.
17. Drejtuesit e njësive ekonomike dhe hartuesit e pasqyrave financiare, në disa raste i plotësojnë këto të fundit me mangësi, për disa veprime kontable, të cilat legjislacioni fiskal nuk i pranon si të tilla, nëse ato nuk kanë kaluar në sistemin bankar. Ngjarje të hasura më shpesh janë: paga të punonjësve të paguara , qeratë e paguara dhe shpenzime të tjera që i shërbejnë aktivitetit të entiteteve, të paguar jashtë sistemit bankar.
18. Në sektorin e ndërtimit nuk është zgjidhur plotësisht çështja e kontratës që pronari i tokës ka me shoqërinë e ndërtimit, konkretisht për shkak të specifikave të ligjit të tatimit mbi të ardhurat dhe të TVSH . Pjesa ndërtimore në m 2 që përfiton pronari i tokës nga ndërtimi në momentin e

trasferimit të pronësive ( kleringu) e vlerësuar me çmimin mesatar të shitjes mbetet në aktiv të pasqyrave financiare si detyrim dhe ne pasivë si fitim i llogaritur për të cilën shoqëria nuk e përfiton realisht.

19. Raste të cilat kërkojnë një trajtim më të zgjeruar konkretisht

1-Kur nje grant paraqitet si detyrim dhe kur ai paraqitet në të ardhura

2- Paraqitja e fshirjes të një borxhi që njësia ekonomike ka ndaj të tretëve apo e kundërta , (rasti më specifik është kur këtë borxh e financion vet shteti.)

20. Hartuesit e Pasqyrave Financiare paraqesin inventarin me koston historike të blerjes, duke zgjedhur metodën më të thjeshtë për ta. Si duhet nxitur zbatimi korrekt i standardit?

21. Gjatë procesit të prodhimit të inventareve, amortizimi nuk duhet të njëhej si amortizim periudhe, por si kosto e inventarit, si të zgjidhet kjo?.

22. Është bërë përcaktim mbi tokën e minierave dhe tokën për groposje të cilat janë objekt amortizimi. Ky përcaktim i Standardit ka hasur jo pak vështirësi në praktikë pasi po t'i referohemi legjislacionit tatumor, nuk ka një përcaktim të qartë për llogaritjen e amortizimit të tokës.

23. Në lidhje me AAM dhe AAJM të mbajtura për shitje më shpesh është ndeshur fenomeni i trajtimit të tyre si AAM ose AAJM në pozicionin normal edhe pse njësia ka qenë në përfundim të përpjekjeve për shitjen e mundshme të tyre brenda 12 muajve të ardhshëm. Një nga arsytet është se ndikonte në rezultatin fiskal të vitit të mëparshëm, pra një shpenzim amortizimi më i ulët dhe një fitim më i lartë.

24. Vlerësimi i AAM dhe AAJM, për kushtet e Shqipërisë ndeshet në vështirësi si rezultat i mungesës së tregjeve për aktivet. Kostot e vlerësimit janë një tjetër element që pengon vlerësimin e këtyre aktiveve. Disa kontabilistë shpesh preferojnë të evidentojnë ngjarjet pasi ndodhin dhe jo të pasqyrojnë një ngjarje që ka propabilitet të lartë për të ndodhur.

25. Në praktikën shqiptare vazhdon të mbizotërojë orientimi i raportimit financiar për efekte tatumore.

26. Del nevoja e një organizmi të veçantë monitorimi për zbatimin e SKK-ve.

### **i) Projekti i Qendrës kombëtare të biznesit për publikimin online të informacionit financiar të njësive ekonomike me asistencën teknike të Baker Tilly Albania**

Në kuadër të projektit të Bankës botërore ku përfitues i asistencës teknike është QKB, KKK pati një takim me përfaqësues të QKB dhe Baker Tilly Albania .

Takimi preku disa çështje që kishin të bënin me vlerësimin e gjendjes aktuale të dorëzimit dhe publikimit të pasqyrave financiare, formatet e propozuara për dorëzimin e pasqyrave financiare si dhe çështje të tjera . Këto çështje u shtruan në mbledhjen e Bordit të KKK i cili pasi diskutoi mbi formatin e pasqyrave të propozuara nga Baker Tilly pohoi në unanimitet se është plotësisht kundër çdo formati tjetër të ndryshëm nga ai që është publikuar në SKK



## Detyrat në 6-mujorin e dytë

### a) Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

Aktualisht SNRF 16 është përkthyer, rishikuar dhe publikuar si pjese e variantit të konsoliduar 2016

<i>Titulli</i>	<i>datë efektive</i>
SNRF 16	1 janar 2019

Gjatë 6-mujorit të dytë IASB ka dërguar disa materiale për azhurnimet e vitit 2016 të cilat janë pjesë e versionit të konsoliduar 2017. Këto materiale do të kalojnë procesin e përkthimit me anë të programit trados, dhe atë të rishikimit, procese të cilat realizohen nga ana e komitetit të rishikimit në bashkëpunim me stafin.

### b) Vëzhgime të pasqyrave të siguruara nga KKK

Gjatë 6-mujorit të dytë janë kontrolluar rreth 150 njësi ekonomike. Nuk u konstatua asnjë problem me rëndësi prandaj stafi me porosi të Bordit do të kalojë në një metodologji të re të inspektimit dhe monitorimit të Standardeve ndërkombëtare duke kaluar në kontrollin në terren.

### c) Formularët e dekriminalizimit

Në vijim të shkresës së mbërritur nga DAP, stafi mori masat për të realizuar procedurën e dorëzimit të formularëve të dekriminalizimit për anëtarët dhe drejtuesin e stafit. Formularët janë publikuar në faqe dhe po priten përgjigjet (sipas kërkesës së ligjit) nga Drejtoria e Burgjeve dhe Drejtoria e Gjendjes Civile për secilin prej subjektete të ligjit të detyruar për plotësimin e formularit.

### d) Shitja e teksteve

Tekstet Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Plotësimi i Pasqyrave Financiare, të botuara respektivisht në 1.200 kopje dhe 500 kopje, në fund të vitit 2016 kanë mbetur gjithsej **736 dhe 211 kopje.**

### e) Takimi Studentor

Në datën 15 Dhjetor 2016 pranë ambienteve të hotel Tirana International u zhvillua një aktivitet me pjesëmarrjen e studentëve më të mirë të vitit të fundit në sistemin bachelor dhe studentë të nivelit master si edhe përfaqësues nga stafi akademik i disa Universiteteve publike dhe private, degët e kontabilitet/financës. Të ftuar nderi ishin: Z. Kule, Z. Bundo, Z. Malaj, dhe Zj. Risilia. Ky aktivitet kishte karakter promovues si edhe teknik në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. I'u dha mundësia studentëve pjesëmarrës, që të njihen me detyrat dhe funksionet e KKK-së si dhe me zhvillimet më të fundit në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Një

nga qëllimet e këtij eventit ishte dhe krijimi i një network-u mes departamenteve të kontabilitetit në Fakultetet e Ekonomisë, i cili do të mundësojë në të ardhmen një shpërndarje më të mirë dhe më të shpejtë të informacioneve lidhur me ndryshimet dhe përditësimet në lidhje me kontabilitetin dhe raportimin financiar, të miratuara dhe publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Jemi në pritje të kthimit të firmosuar apo me sugjerime për ndryshime të marrëveshjeve të bashkëpunimit midis Universiteteve dhe KKK.

#### **f) Amendimet e ligjit të Kontabilitetit**

Në vijim të diskutimeve të grupit të punës së përbërë nga përfaqësues të KKK-së, Min Fin dhe MZHETS u ra dakord që të kërkoheshin financime të huaja për të mbështetur ofrimin e konsulencës së huaj në thellimin e diskutimeve mbi klasifikimin e njësive ekonomike. GIZ pranoi kërkesën e grupit të punës dhe mundësoi dy vizita 4 ditore në Tiranë të një Konsulenti të huaj. Në misionin e parë në korrik 2016 konsulenti organizoi dy seminare, seminari i parë shërbeu për njohjen më të mirë të grupit të punës me Direktivën 34/2013 ndërsa seminari i dytë prezantoi diferencat mes ligjit të kontabilitetit dhe Direktivës së Kontabilitetit, duke u ndalur kryesisht në diferencat themelore të konstatuara edhe nga stafi i Bankës Botërore:

Përfundimet dhe gjetjet kryesore janë përmbledhur më poshtë.

1. Pjesë të rëndësishme të Direktivës së Kontabilitetit nuk janë transpozuar në legjislacionin shqiptar. Për shembull, informacioni që duhet të jepet në shënimet e pasqyrave financiare është transpozuar pjesërisht në SKK. Përveç kësaj, në Direktivë ka kërkesa specifike për dhënie informacionesh shpjeguese të aplikueshme për njësitë, të cilave ju kërkohet apo lejohen të zbatojnë SNRF (psh art. 17 dhe 18) dhe si pasojë do të ishte më mirë që të kërkoheshin nga ligji / aktet nënligjore.
2. Klasifikimi i njësive shqiptare në mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha nuk është e krahasueshme me kriteret e përcaktuara në art 3 të direktivës dhe mund të arrijmë në përfundimin se njësitë e vogla në Shqipëri janë të detyruar të japin në shënimet shpjeguese më shumë informacion në pasqyrat e tyre financiare vjetore sesa njësitë e ngjashme për nga madhësia në BE. Grupet e njësive nuk janë të përcaktuara.
3. Nuk ka kërkesa të qarta në aktet normative, të paraqitura për shqyrtim mbi përmbajtjen e raportit të menaxhimit, duke përfshirë pasqyrat jo financiare dhe pasqyrën e qeverisjes së korporatave dhe të njësive që do ju kërkohet për të përgatitur dhe dorëzuar këto raporte / pasqyra; e njëjta gjë dhe për raportin e menaxhimit të konsoliduar (art.19.19a, 20, 29, 29a).
4. Nuk ka kërkesa për audituesi për të shprehur opinionin nëse raporti i menaxhimit (përfshirë raportin e menaxhimit të konsoliduar) është në përputhje me pasqyrat financiare.
5. Kërkesat në lidhje me raportimin e pagesave ndaj qeverisë të njësive ekonomike të sektorit të industrive nxjerrëse, nuk janë transpozuar.
6. Të tjera informacione

Në misionin e dytë shtator 2016, konsulenti paraqiti propozimin e tij për ndërhyrjet e nevojshme në ligj në kontekstin e transpozimit të Direktivës. Drafti u konsultua nga grupi i punës, u pranua dhe më pas i'u propozua KKK-së draft ligji i kontabilitetit me ndryshimet e reja. Ndryshimet e reja i'u dërguan për mendim Ministrisë të Financave.

1. Klasifikimi i ri i njësive ekonomike;
2. Klasifikimi për herë të parë i grupeve;
3. Përjashtohen grupet e përbëra nga mikronjësi apo njësi të vogla që të hartojnë pasqyra të konsoliduara, përveç rastit kur ndonjë prej njësive të grupit është me interes publik;
4. Njësitë ekonomike që në kuptim të këtij ligji klasifikohen të mesme, të mëdha dhe njësi me interes publik duhet të japin informacion për:
  - numrin mesatar të të punësuarve të ndarë sipas kategorive; dhe
  - nëse nuk janë paraqitur si nën zëra të veçantë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, shpenzimet e personelit për vitin ushtrimor duhet të paraqiten të ndara në paga dhe shpërblime, shpenzime për kontribute dhe të tjera përfitime;
5. Njësitë ekonomike të mëdha dhe ato me interes publik paraqesin në shënimet shpjeguese tarifatat gjithsej për vitin financiar të kërkuara nga secili auditues ligjor apo firmë auditimi në lidhje me auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, dhe tarifatat gjithsej të kërkuara nga secili auditues ligjor ose firmë auditimi për shërbimet të tjera të sigurisë, për shërbime këshillimore tatimore dhe për shërbime të tjera jo auditimi.
6. Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik do të publikojnë pasqyrat financiare vjetore në faqet e tyre zyrtare të internetit jo më vonë se 30 ditë pas miratimit të pasqyrave nga organi përgjegjës. Detyrohen të publikojnë pasqyrat financiare vjetore në faqet e tyre zyrtare të internetit edhe njësitë ekonomike jofitimprurëse, subjekt i këtij ligji, nëse shifra e aktivitetit ose e të ardhurave në pasqyrat financiare tejkalon vlerën 30 milion lekë.
7. Neni 8 “Përbërësit e pasqyrave financiare” bëhet i zbatueshëm për njësitë ekonomike të vogla 2 vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në periudhën tranzitore njësitë ekonomike të vogla do të hartojnë pasqyrat financiare vjetore sipas SKK 2, i përmirësuar (publikuar korrik 2014).

#### **g) Tabela e përputhshmërisë**

Banka Botërore, në kuadër të bashkëpunimit me Qeverinë shqiptare për transpozimin e Direktivave të BE-së në legjislacionin vendas hartoi një tabelë të re përputhshmërie, tashme me SKK-të e përmirësuara dhe ligjin të shoqëruar me amendimet e propozuara në Janar 2016 tek Ministri i Financave. Nga tabela dolën disa diferenca që kryesisht i referoheshin klasifikimit të njësive ekonomike, shënimeve shpjeguese, raportimit të menaxhimit dhe disa kërkesa ndaj

audituesve. Mbi këtë tabelë u punua për çdo rresht ku ishte shënimi “pjesërisht” ose “mungon”. Përkrah tabelës u vendos një kollonë shtesë, me sugjerimet për masat për t’u ndërmarrë. Kryesisht ndërhyrjet u pa me vend të ishin në 14 SKK-të dhe pjesa tjetër tek ligji i kontabilitetit, ligji për shoqëritë tregtare, ligji i auditimit dhe ligji për QKB-në.

Masat e propozuara i’u dërguan Bankës Botërore e cila rekomandoi më pas që për një lëvizje më të shpejtë ndërhyrjet të bëheshin vetëm në ligjin e kontabilitetit dhe tek Standardet.

Ky proces tashmë është nën mbikqyrjen e Ministrisë së Financave.

#### **h) Materiale për zbatimin e SKK 13, seksioni i marrëveshjeve koncesionare**

Me porosi të Bordit, në përgjigje të interesimit të subjekteve për ilustrime në zbatimin e standardit për marrëveshjet koncesionare, stafi punoi për përkthimin dhe përshtatjen me realitetin vendas të ushtrimeve bashkëngjitur IFRIC 12. Këto ushtrime me miratimin e tyre në Bord do të publikohen në faqen e internetit të KKK-së.

*Stafi i KKK-së, Tiranë 18.01.2017*